

## **PROCEDURA PENALE PARA GJYKATËS SË APELIT DHE VENDIMMARRJA E SAJ GJATË PERIUdhËS 2015-2019**

Kandidate: Njomza Svarça

Mentori: Prof. Dr. Azem Hajdari

E drejta e procedurës penale studion veprimtarinë e subjekteve të procedurës penale në arritjen e synimeve dhe kërkesave të ligjvënësit për zbardhje të gjithanshme dhe zgjidhje të drejtë të çështjes penale. Pra, e drejta e procedurës penale ndikon në zhvillimin dhe përsosjen e sistemit procedural, në atë mënyrë që të jetë në funksion të mbrojtjes efikase të shoqërisë nga kriminaliteti.

Sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë procedura penale zhvillohet në Gjykatat Themelore, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Ashtu që gjykimi në vendin tonë parimisht zhvillohet në dy shkallë por, në rastet shprehimisht të përcaktuara me ligj procedura penale mund të zhvillohet edhe në shkallë të tretë. Kjo nënkupton se pala e pakënaqur me vendimin gjyqësor mund të paraqes mjetin juridik në gjykatën drejtpërdrejtë më të lartë. E gjithë kjo mundësohet përmes mjeteve juridike me të cilat palët dhe personat e autorizuar në procedurë atakojnë vendimin të cilin e konsiderojnë jo të drejtë dhe të ligjshëm dhe me anë të cilave mundësohet të eliminohen të metat eventuale të cilat mund ti ketë vendimi i atakuar.

Procedura penale para Gjykatës së Apelit mund të zhvillohet vetëm pasi të ketë përfunduar gjykimi në shkallë të parë dhe pasi të jetë ndërmarr iniciativa e personit të autorizuar përmes paraqitjes së ankesës. Ashtu që gjykimi në shkallë të dytë është stad i veçantë i procedurës penale. Por, pavarësisht veçorive që paraqet gjykimi në shkallë të dytë konsiderohet pjesë e procedurës dhe si e tillë i shërben qëllimit përfundimtar të saj.

Fjalë kyçe: Gjykata e Apelit, procedura penale, vendimmarrja, mjetet juridike, ankesa, personat e autorizuar, seancë e kolegjit, shqyrtim gjyqësor, reformatio in peius, beneficium cohaesionis, ngarkesa e gjykatës etj